

**Srgjan Atanasovski** (Srđan Atanasovski)

Instituti i Muzikologjisë

Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve

## **Prodhimi i Serbisë së Vjetër: në hapa të udhëtarëve, pas gjurmëve të folklorit**

### **Abstrakt:**

Në këtë punim analizoj udhëpërshkrimet nga “Serbia e Vjetër”, të cilat në Serbinë e fundshekullit të gjatë XIX përbëjnë një zhanër specifik letrar, si një mekanizëm për prodhimin e pretendimeve territoriale të nacionalizmit serb. Në periudhën kur vendet e përshkruara ishin nën pushtetin osman dhe shiheshin si të paarritshme për shumicën e pjesëtarëve të popullatës serbe, e cila, megjithatë, i perceptonte ato si pjesë substanciale të territorit të vet nacional, këto udhëpërshkrime ishin një mënyrë unike që opinionit t’i paraqiten informacione të drejtpërdrejta që kishin të bënin me ato vise. Pas një trajtimi të shkurtër historik të zhvillimit të zhanrit, analizoj mekanizmat letrare me anë të të cilave këto toka u shenjuan bindshëm si serbe. Theksoj në mënyrë të veçantë rëndësinë e paraqitjes së të dhënave shkencore në ato udhëpërshkrime, siç janë ato që kanë të bëjnë me gjuhën, zakonet dhe të ngjashme.

---

### **Fjalët kyçe:**

nacionalizmi serb, Serbia e Vjetër, Maqedonia, udhëpërshkrimet, etnografia

Në periudhën nga mesi i shekullit XIX deri në shpërthimin e Luftërave Ballkanike, intelektualët serbë, kryesisht nga Principata, respektivisht Mbretëria e Serbisë, por dhe nga qendrat në monarkinë e Habzburgëve, i dhanë jetë një diskursi specifik të udhëpërshkrimit nga Serbia e Vjetër.<sup>8</sup> Qëllimi themelor i këtyre udhëpërshkrimeve ishte që, duke përdorur shkenca si historia, filologjia, etnografia dhe gjeografia, të fuqizoheshin argumentet nacionaliste serbe, sipas të cilave vise të caktuara gjeografike i përkisnin kombit serb. Por qëllim i tyre ishte po ashtu edhe pasurimi i teksteve shkencore me dëshmitë personale të hulumtuesve me anekdota piktoreske dhe skena nga jeta e përditshme. Për këto arsye në udhëpërshkrime gërshetoheshin të dhëna të shumëllojshme demografike, informacione historike, por edhe harta etnografike që i gjejmë në formë shtojcash, të cilat nuk ishin vetëm rezultate shkencore objektive, por përfaqësonin një pjesë përbërëse të një zhanri letrar, me të cilin që i mundur zgjimi i një reagimi të fuqishëm afektiv te publiku lexues. I parë nga perspektiva e kontributit artistik, udhëpërshkrimi ndërkaq shërbente si dëshmi mbi përvojën e drejtpërdrejtë të udhëpërshkruesit dhe si gjurmë materiale e qëndrimit fizik të rrëfimtari në hapësirën që dëshironte të përshkruajë. Për këtë arsye, lexuesit konsideronin se udhëpërshkruesi me rrëfimin e vet mund të ndante me publikun mbresa nga udhëtimi, të cilat ai i kishte provuar vetë.

Në këtë punim do të paraqes një pasqyrë të shkurtër historike të zhvillimit të diskursit të udhëpërshkrimeve nga Serbia e Vjetër dhe do të shqyrtoj teknikat letrare kyçe me anë të të cilave këto udhëpërshkrime kanë funksionuar si mekanizëm i përvetësimit të territoreve. Më tej, në mënyrë të detajuar do të analizoj rolin politik të trajtimeve të gjuhës dhe folklorit të këtyre viseve në prozën udhëpërshkruese, si dhe në tekstet shkencore, të cilat gjithashtu krijoheshin si derivate të një lloji të veçantë të udhëpërshkrimeve. Në bazë të kësaj mund të konkludojmë se mekanizmat e përvetësimit diskursiv të territoreve ndryshonin në rastin e Serbisë së Vjetër në kuptimin e ngushtë të këtij koncepti (i cili përfshinte për afërsisht Kosovën, Shqipërinë veriore dhe, jo gjithmonë, Maqedoninë veriperëndimore, e në të cilën kombi kundështar ishte ai shqiptar)<sup>9</sup>, nga rasti i Maqedonisë, ku objekt i sulmit ishte e ashtuquajtura ‘propagandë bullgare’ dhe shumica e banorëve flisnin gjuhën sllave. Ndërkohë që në rastin e dytë udhëpërshkruesit përdornin analizën e gjuhës, folklorit dhe zakoneve të ngjashme, që me metodë shkencore të përcaktonin kufijtë e kombit, e përmes

<sup>8</sup> “Nocionin ‘Serbia e Vjetër’, të cilin për arsye të qartësisë ortografike e shënoj pa thonjëza, nuk e përdor në kuptimin e një hapësire gjeografike reale, por si një referencë për fushën e konstruktuar të domethënies së prodhuar në diskursin nacionalist serb gjatë shekullit XIX, e i cili konsiderohej si pjesë substanciale e territorit nacional imagjinar serb (Krah. Trifunović, 2014). Udhëpërshkrimet nga Serbia e Vjetër të shkruara në gjuhën serbe nuk janë trajtuar si një temë më vete. Dushan Bataković (Dušan Bataković) ka përgatitur një antologji shënimesh për Kosovën nga viti 1852 deri më 1912, por në fokusin e interesimit të tij nuk është elementi udhëpërshkrues, edhe pse shumica e teksteve në atë përmbledhje janë të këtij tipi (Bataković, 1988). Në studime të veçanta janë trajtuar aspekte të caktuara të udhëpërshkrimit të Branislav Nushiçit (Branislav Nušić) nga Kosova e Maqedonia (Peković, 2001).”

<sup>9</sup> Duke marrë për bazë tiparet gjeografike të këtyre viseve, Jovan Cvijiç (Jovan Cvijiç) e caktoi kufirin midis Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë në mënyrë të tillë që Shkupi të ishte në Serbinë e Vjetër, ndërkohë që Maqedoninë e kufizonte në viset rreth Ohrit dhe Manastirit, me çka pajtohej edhe Tihomir Gjorgjeviç (Tihomir Đorđević) (Cvijiç, 1904; Đorđević, 1920, 4).

kësaj t'i njihnin “të drejtën natyrore” popullatës aktuale (sllave dhe të krishterë), në rastin e territoreve ku shumicën e përbënin shqiptarët mekanizmat e përvetësimit mbështeteshin mbi narracione historike, argumente gjeografike-ekonomike, e jo rrallë edhe mbi fabrikimin e të dhënave demografike, duke e hapur kështu hapësirën për diskriminimin racor dhe kulturor të popullatës joslave.

\* \* \*

Edhe pse miti i Kosovës ishte i pranishëm fuqishëm që nga koha e Vuk Karaxhiqit (Vuk Karadžić), si në arte dhe shkencë, ashtu edhe në jetën e përditshme të serbëve në Principatë dhe në provincat e monarkisë së Habzburgëve, deri në Kongresin e Berlinit kishte përpjestimisht pak dëshmi direkte prej serbëve që vërtet e kishin vizituar Serbinë e Vjetër dhe Maqedoninë<sup>10</sup> dhe të cilët mund t'i informonin bashkëkombasit e vet për faktet duke iu referuar përvojës personale. Këtë e provon edhe thënia e Karaxhiqit nga teksti *Serbët të gjithë e kudo ku janë* i vitit 1836, se ka pasur dëshirë t'i vizitojë “këto vise juglindore të popullit tonë [...] por gjer më sot assesi nuk më shkoi përdore” (Karadžić, 1972, 31).

Konsiderohet se në dekadat e para të shekullit XIX, viset e Perandorisë Osmane ishin të rrezikshme për udhëtime hulamtuese dhe se “mund të kalohej sigurt vetëm me një përcjellje të fortë turke” (Bataković, 1988, ix). Njëkohësisht, gjithandej Evropës po rritej interesimi për literaturë udhëpërshkruese, si dhe për studime të shumëllojshme etnografike të bazuara në përvojën personale të hulamtuesit. Në këtë kuadër, në shtyp dhe publikime të veçanta speciale filluan të botoheshin udhëpërshkrime jo vetëm nga Principata e Serbisë, por edhe nga Mali i Zi, Hercegovina dhe Bosnja, si dhe trajtesa mbi zakonet apo shënime të mbledhura nga vetë udhëpërshkruesit. Për shkak të gendjes më të mirë materiale, përqëndrimin të pasurisë dhe përmirësimit të rrjetit të rrugëve, udhëtimi si metodë arsimimi, hulumtimi, por edhe i kalimit të kohës së lirë, po bëhej gjithnjë e më i përhapur në kulturën e klasës borgjeze, si në hapësirat e Austro-Hungarisë, ashtu edhe në Principatën e Serbisë (Stanojević, 2007). Në këtë kontekst binte dukshëm në sy mungesa e udhëpërshkrimeve nga viset që proklamoheshin si Serbi e Vjetër dhe të cilat zgjonin një kërshtëri të madhe. Për interesimin në rritje të publikut lexues për udhëpërshkrime nga Serbia e Vjetër dëshmon edhe fakti që, duke filluar nga vitet 50 të shekullit të XIX, në shtypin serb filluan të shfaqen fragmente

<sup>10</sup> Në diskursin nacionalist serb gjatë shekullit XIX janë përdorur paralelisht të dy variantet ortografike – “Makedonija” dhe “Maçedonija” – por këtu përdor varjantin e dytë, së pari për të nënvizuar dallimin nga hapësira reale gjeografike, Makedonija/Maqedonia, por edhe duke patur parasysh se prania (ose përdorimi) e shkronjës “ç/q” në ortografinë e fjalës së prejardhjes maqedone është nënvizuar si dëshmi se bëhet fjalë për një dialekt të gjuhës serbe, e jo, për shembull, të gjuhës bullgare. Fjalën “Mekedonija” (shqip – Maqedonia –, por në këtë kontekst lexuesi i tekstit në shqip është i detyruar që ta hetojë këtë dallim nga konteksti, vër. e për.) e përdor si fjalë për një hapësirë konkrete gjeografike, ndërsa “Maçedonija” (edhe në shqip. Maqedonia – vër. e për.), si dhe Serbia e Vjetër, i referohet hapësirës imagjinare të territorit serb të prodhuar në kuadër të nacionalizmit serb.

nga udhëpërshkrime të huaja, të cilat kishin të bënin me territoret europiane të Perandorisë Osmane, e më pas edhe përkthime të plota të monografive të ndryshme (Bataković, 1988, xii-xiii).

Udhëpërshkrimi i parë mbi Serbinë e Vjetër i shkruar nga pena e një autori serb është botuar në vitin 1852 dhe fjala është për trajtesën *Fillesa e Deçanit* (1852) e murgut Gedeon Josif Jurishiq (Gedeon Josif Jurišić), i lindur në Irig në vitin 1809, i cili për disa vite kishte qëndruar në Manastirin e Deçanit, prej nga udhëtonte nëpër viset përreth. Pjesa më e madhe e veprës së Jurishiqit ka të bëjë me vetë manastirin, arkitekturën e tij, afreskat, si dhe dorëshkrimet dhe pasuritë e thesarit të tij. Në pjesën përfundimtare të tekstit, Jurishiq përshkruan viset e Kosovës, Metohisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nëpër të cilat kishte udhëtuar, jo rrallë duke i trajtuar ato nga prizmi i historisë mesjetare, por flet edhe për rrethanat aktuale politike, duke theksuar rrezikun që i kërcënohej popullsisë serbe dhe fatin e pasigurt të vetë manastirit. Duke i quajtur të gjitha këto vise si serbe, Jurishiqi vë në pah se teksti i tij ishte shkruar në bazë të ftesës së serbëve të arsimuar në Austri që të hulumtonte dhe përshkruante “viset serbe” dhe “antikitetet serbe” (Юришић, 1852, iii). Bazat e zhanrit të udhëpërshkrimit nga Serbia e Vjetër i vendosi, ndërkaq, Millosh S. Millojeviqi (Miloš Milojević), historian, politikan dhe shkrimtar, i cili pas udhëtimit të tij nëpër Serbinë e Vjetër botoi dy vepra, një udhëpërshkrim prej tri vëllimesh (1871-1877) dhe një studim shkencor për demografinë, etnografinë dhe gjeografinë e atyre anëve (1881). Më herët, në vitin 1866, Millojeviqi botoi një trajtesë drejtuar kundër “propagandës bullgare” në Serbinë e Vjetër dhe në Maqedoni dhe filloi të shkruajë edhe një vepër tjetër kapitale, *Këngët dhe zakonet e tërë popullit serb* (1869-1875). Millojeviqi ishte politikisht aktiv, duke vepruar në institucione si Shoqëria e Shën Savës, ndërkohë që rrugën për në Serbinë e Vjetër e mori me rekomandim me shkrim të ministrit të atëhershëm të arsimit, Dimitrije Matiq (Dimitrije Matić) dhe mitropolitit të Beogradit, Mihaillo.

Aspekte të caktuara që mund të hasen në udhëpërshkrimet e Millojeviqit, e deri diku edhe tek ai i Jurishiqit, shfaqen me konsekuencë edhe në veprat e udhëpërshkruesve të mëvonshëm: primati i narracionit hapësinor mbi atë kohor, fshirja e kohës si një përcaktues i rëndësishëm në narracion – respektivisht, hyrja në një lloj gjithë-kohësie të zhanrit udhëpërshkrues – motivi i kërcënimit dhe, më në fund, gërshetimi i të dhënave shkencore, demografike dhe historike me prozën udhëpërshkruese. Millojeviqi e realizon gërshetimin e qasjes shkencore dhe tekstit letrar, si në vetë udhëpërshkrimin, për shembull, duke parashtruar të dhëna demografike të detajuara në kuadër të përshkrimit të udhëtimit të tij, ashtu edhe në nivel të opusit të tij më të gjerë, duke botuar, në distancë kohore të caktuar, si shtojcë të udhëpërshkrimit, studimin shkencor përcjellës. Këtë strategji, pas Millojeviqit, do ta përsërisin shumë udhëpërshkrues. Kështu, Branisllav Nushiq (Branislav Nušić) studimin e vet shkencor *Kosova. Përshkrimi i tokës dhe i popullit* e publikoi një vit pas udhëpërshkrimit letrar monografik nga Kosova.

Një varg udhëpërshkrimesh të rëndësishme nga Serbia e Vjetër u botuan në vitet që pasuan luftën serbo-bullgare, e cila e aktualizoi edhe më shumë kërcënimin e “propagandës bullgare”. Shkencëtarët dhe politikanët në zë të kësaj kohe, Vladimir Kariq (Vladimir Karić) dhe Stojan Novaković (Stojan Novaković), botuan “shënime udhëtimi” të tyre, respektivisht në vitin 1889 dhe 1892. Stojan Novaković ishte i njohur për opinionin publik serb si historiani dhe filologu më në zë, ndërsa Vladimir Kariq është marrë kryesisht me etnografi dhe gjeografi. Edhe pse në krahasim me veprat e tyre kryesore këto “shënime” përbëjnë një pjesë relativisht të vogël dhe më pak të rëndësishme, është interesante se ata konfirmojnë imperativin se krijuesit shkencorë duhet të shprehen drejtpërdrejt edhe si udhëpërshkrues-reporterë, si dhe të dëshmojnë në bazë të qëndrimit personal në viset që i përshkruajnë dhe në bazë të njohurive të fitura në terren. Këtë imperativ e provon në një mënyrë specifike edhe studimi i Spiridon Gopçevićit (Spiridon Gopčević). I botuar fillimisht në gjuhën gjermane, udhëpërshkrimi i Gopçevićit u ribotua në gjuhën serbe në vitin 1890, me përkthimin e Millan Kasumovićit (Milan Kasumović). I konceptuar në dy libra, pjesa e parë e tekstit të Gopçevićit është në formë udhëpërshkrimi, si përshkrim personal dhe i detajuar i vetë udhëtimit, ndërsa pjesa e dytë, nën titullin “Kontestimi serbo-bullgar rreth Maqedonisë dhe Serbisë së Vjetër”, përfaqëson një trajtesë politiko-shkencore drejtuar kundër të “drejtës natyrore” dhe të “drejtës historike” bullgare mbi këto vise, në të cilin autori u referohet njohurive nga fusha e historisë, filologjisë, etnografisë dhe etimologjisë, por edhe e udhëzoi lexuesin te pjesa udhëpërshkruese e studimit, në të cilën mund të gjejë një varg situatash me të cilat konfirmohen të tilla pikëpamje.<sup>11</sup>

Midis udhëpërshkruesve që veprat e tyre i kanë botuar në dekadën e parë të shekullit XX shquhen posaçërisht Branislav Nushiç dhe Ivan Ivaniq (Ivan Ivanić). Krahas faktit që ishte një shkrimtar dhe poet i mirënjohur, Nushiçi merrej në mënyrë aktive edhe me politikë; në vitin 1890 ai qëndroi disa muaj në konsullatën serbe në Shkup, ndërsa nga viti 1893 deri në vitin 1896 ishte konsull i Mbretërisë së Serbisë në Prishtinë (Jovanović, 1938). Nushiçi ka botuar dy udhëpërshkrime – *Nga brigjet e Liqenit të Ohrit* (1894) dhe *Nga Kosova në detin blu* (1902) – të cilët në kuadër të këtij zhanri mund të veçohen nga cilësia e shkëlqyer letrare. Zotërimi i shkathët i narracionit të Nushiçi i ka mundësuar që, ndoshta në mënyrë më fatlume se në rastin e udhëpërshkruesve të tjerë, të nënvizojë dimensionet e hapësirës në dëm të dimensionit të kohës dhe kështu t’i japë tekstit shpirt me dialogë dhe refleksione lirike. Krahas këtyre dy veprave, Nushiçi, si duket pas shembullit të Millojeviqit, në vitet 1902-1903 botoi studimin shkencor *Kosova. Përshkrimi i tokës dhe i popullit*, duke u marrë kryesisht me çështje etnografike. Ngjashëm me Nushiçin ka vepruar edhe Ivan Ivaniq, nëpunës i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili në kuadër të shërbimit diplomatik ka qëndruar në Prishtinë, Selanik, Manastir dhe Stamboll, duke botuar disa udhëpërshkrime nga Maqedonia dhe Serbia e Vjetër (1901-1903) dhe studimin udhëpërshkrues-shkencor *Maqedonia dhe maqedonët* (1906-1908).

<sup>11</sup> Autorë bashkëkohorë e kanë vënë në dyshim autenticitetin e “udhëpërshkrimit” të Gopçevićit, duke konkluduar se autori në të vërtetë nuk kishte qëndruar në viset e përshkruara të Perandorisë Osmane (Heim, 1966, 90-114; kra. Promitzer, 2015, 204-205).

**Tabela 1. Kronologjia e udhëpërshkrimeve më të rëndësishme nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia**

Viti	Vepra	Forma
1852.	Gedeon Josif Jurišić: <i>Dečanski prvenac (Fillesa e Deçanit)</i>	Udhëpërshkrim letrar (përfshin përshkrimin e manastirit)
1871–1877.	Miloš S. Milojević: <i>Putopis dela prave (Stare) Srbije (Udhëpërshkrim i një pjese të Serbisë (së Vjetër) së Vërtetë)</i>	Udhëpërshkrim letrar (me disa ilustrime)
1875–1882.	Panta Srecković: <i>Putničke slike (Kosovo; Familijarna grobnica Mrnjavčevića; Podrim i Metohija) (Kosova; Varreza familjare e Mrnjavčevićëve; Përdrinia dhe Metohia)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1889.	Vladimir Karić: <i>Carigrad, Sveta Gora, Solun. Putničke crtice s beleškama o narodnoj propagandi na Istoku (Stambolli, Mali i Shenjtë, Selaniku. Skica udhëtimit me shënime për propagandën popullore në Lindje)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1890.	Spiridon Gopčević: <i>Stara Srbija i Makedonija. Moj putni izveštaj (Serbia e Vjetër dhe Maqedonia. Raporti im i udhëtimit)</i>	Udhëpërshkrim etnografik
1892.	Stojan Novaković: <i>S Morave na Vardar: 1886. Putne beleške (Nga Morava në Vardar: 1886. Shënime udhëtimit)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1894.	Spira Kalik: <i>Iz Beograda u Solun i Skoplje s Beogradskim pevačkim društvom: putničke beleške (Nga Beogradi në Selanik e Shkup me shoqërinë beogradase të këndimit: shënime udhëtimit)</i>	Udhëpërshkrim letrar / reportazh (me disa ilustrime)
1894.	Branislav Nušić: <i>S obala Ohridskog jezera (Nga brigjet e Liqenit të Ohrit)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1895.	Milojko V. Veselinović: <i>Pogled kroz Kosovo (Vështrim nëpër Kosovë)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1892–1902.	Branislav Nušić: <i>S Kosova na sinje more (Nga Kosova në detin blu)</i>	Udhëpërshkrim letrar

1903.	Ivan Ivanić: <i>Na Kosovu: Sa Šara, po Kosovu, na Zvečan. Iz putnih beležaka Ivana Ivanića (Në Kosovë: nga Sharri, nëpër Kosovë, në Zvečan. Nga shënimet e udhëtimit të Ivan Ivaniqit)</i>	Udhëpërshkrim letrar
1906–1908.	Ivan Ivanić: <i>Maqedonija i Maqedonci. Putopisne beleške (Maqedonia dhe maqedonët. Shënime udhëpërshkruese)</i>	Udhëpërshkrim dhe studim demografik, etnografik dhe gjeografik
1910.	Todor P. Stanković: <i>Putne beleške po Staroj Srbiji: 1871–1898. (Shënime udhëtimi nëpër Serbinë e Vjetër: 1871-1898)</i>	Udhëpërshkrim në formë reportazhi

\* \* \*

Në analizën e tipareve të udhëpërshkrimeve nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia, detyrë e imja themelore është të identifikoj mekanizmat e caktuar, nëpërmjet të cilave udhëpërshkruesit kanë kryer përvetësimin e këtyre territoreve, duke përcjellë në mënyrë bindëse tek publiku lexues idenë se bëhet fjalë për pjesë kyçe të territorit të përfytyruar kombëtar serb. Bëhet fjalë në vijim për këto procese: fshirja e dimensionit të kohës, apo më qartë ndërtimi i një narracioni që i jep përparësi dimensionit hapësinor dhe kohës historike; fshirja, respektivisht mohimi i kufijve politikë; futja e motivit të kërcënimit dhe, më në fund, futja e metodës dokumentare dhe gërshetimi i prozës udhëpërshkruese me punimin shkencor, për çka do të bëhet fjalë më shumë në kapitullin përmbyllës të këtij teksti.

Primati i dimensionit të hapësirës mbi dimensionin e kohës është një ndër tiparet themelore të rrëfimit, i cili i karakterizon gati të gjitha udhëpërshkrimet nga Serbia e Vjetër. Aspekti kohor i narracionit është i kushtëzuar nga udhëtimi i vetë rrëfimitarit dhe si i tillë nuk përbën një faktor qenësor të këtyre krijimeve. Vendin e tij në të vërtetë e zë hapësira, e cila jo vetëm që e orienton kërkuesin e narracionit, por përfaqëson kriterin bazë në pajtim me të cilin merr formë udhëpërshkrimi dhe renditet një thurje e ndjeshme e anekdotave, dialogjeve, vrojttimeve udhëpërshkruese, por edhe i informacioneve historike, demografike dhe të tjera. Koha reale e udhëpërshkrimit, në të vërtetë, nëpërmjet një lloji të këtillë të narracionit, shkrihet me kohën historike, por edhe me kohën mitike, respektivisht pa-kohësinë. Kështu udhëpërshkruesi, i udhëhequr nga rruga e tij, peizazhet dhe vendet që e rrethojnë, i përshkruan ato jo vetëm nëpërmjet vrojttimeve të tij të çastit, por edhe nëpërmjet rrëfimeve historike dhe besimeve popullore që lidhen me to. Është tipike fjalia e Panta Srečkoviqit (Panta Srečković), me të cilën e përshkruan udhëtimin e tij nëpër Fushën e Drinit: “Nga Mitrovica e Zveçani, udhëtova nëpër vendin ‘Pantino’, ku Nemanja mundi ‘demonët e vet’, për në Prizren” (Srečković, 1882). Referenca të tilla, veçërisht në

udhëpërshkrimet e Millosh Millojeviqit, shndërrohen në ekskurse të elaboruara, në të cilat autori interpreton edhe shënimet historike, të cilat i ka gjetur në udhëtim e sipër të gdhendura mbi rrënoja dhe në shenjat e monumenteve (Krah. p.sh. Milojević, 1871, 121-123).

Është posaçërisht interesante mënyra me të cilën fshirja e dimensionit të kohës zbatohet në nivel të përvojës së përditshme. Stojan Novaković, duke përshkruar në udhëpërshkrimin e tij një han në Bilaç, ku ka bujtur, e krahason atë me përshkrimet e zakoneve të udhëtimit nga Kodi i Dushanit, duke konstatuar se “nëpër disa vise të humbura të Turqisë [...] mesjeta jeton ende në një lulëzim të konsiderushëm” (Novaković, 1894, 17-20), ndërsa ngrohjen me mangall e përshkruan duke iu referuar tipikut të Shën Savës për Studenicën dhe Hilandarin (25-27). Madje edhe në prozën e thatë, dokumentare, të Todor Stankovićit (Todor Stanković), historia e shtetit mesjetar serb është diçka nga e cila nuk mund të iket, diçka e përfutur në vetë thelbin e hapësirës; kështu shkrimtari thekson se “përreth Novo Bërdës dhe në gjithë kazanë e Gjilanit gjatë mihjes dhe lëvrimit [vendasit] gjejnë shpesh para të vjetra serbe dhe gjëra të tjera antike” (Stanković, 1910, 30).<sup>12</sup> Për më tepër, Stanković konkludon me triumfalizëm, “gjithkund, deri atje ku fshatrat, kodrat, lumenjtë e fushat quhen me emra serbë, gjithandej deri në fshatrat e arnautëve ku ka kisha të vjetra, manastire e varreza serbe, [...] nuk ka arbanasë as Shqipëri” (132).

Duke filluar me Jovan Cvijiçin, në diskursin nacionalist serb ishte e gjallë ideja mbi lidhjen organike, e kuptuar si shkak-pasojë, të tipareve natyrore dhe gjeografike të “atdheut” me karakterin dhe veçantitë e kombit. Në pajtim me këtë kuptim të lidhjeve të natyrës dhe kombit, udhëpërshkruesit nga Serbia e Vjetër jo rrallë bukuritë natyrore që i përshkruajnë i interpretojnë përmes prizmit të narrativës së historisë serbe, duke i bashkuar ashtu veçoritë gjeografike me narrativat historikë. Millojeviqi pasurinë e lumit Nerodime e interpreton duke kujtuar kohën e artë dhe prosperitetin ekonomik të Serbisë “perandorake” mesjetare: “Nga ana perëndimore rrjedh lumi i mrekullueshëm, i habitshëm, mjekues i Nerodimes, Rodimka e moçme, plot trofta dhe peshq të tjerë, siç pohojnë, të sjellë nga perandorët serbë madje nga Kina, të cilat edhe në ditët e sotme janë në të” (Milojević, 1871, 201). Një shkrirje më e fuqishme e personazheve historike me peizazhin nëpërmjet figurës fantazmike poetike e ka arritur Millojko Veselinović (Millojko Veselinović), në udhëpërshkrimin e tij *Vështrim nëpër Kosovë* nga viti 1895:

Për më pak se një orë treni tashmë kishte arritur me të shpejtë në Han të Elezit, e që andej për një orë të dytë në Kaçanik. E tmerrshme! Nuk e dini ç’është më e tmerrshme, gryka e Kaçanikut me natyrën e vet, ose Plaku Novak me fytyrën e tij të mrrolur dhe kallpakun plot pikëllim e dëshpërim! [...] Gryka e Kaçanikut e magjeps udhëtarin me natyrën e

<sup>12</sup> Në një vend tjetër Stanković vë re se “xhamitë e Prishtinës dhe disa teqe fshehin brenda vetes shumë antikitet serbe, sepse ato janë shndërruar nga kishat, ndërsa disa janë ngritur edhe me materialin nga kishat dhe pallatet e rrënuara serbe” (Stanković, 1910, 84).



vet. Ajo nuk është shumë shkëmbore, ndërsa është mjaft e pyllëzuar - një vend i duhur për hajdutë. Menjëherë më doli para sysh trimi plak, Plaku Novak dhe sikur e shoh si me çetën e vet fluturon nga kodra në kodër, zë pritën dhe me trimëri e mbron grykën e tij dhe si e vë kallpakun mbi sy! Nëse ai trim edhe ka shikim të tmerrshëm, vërtet kishte pse të jetonte. Vetëm kalo, o serb, andej, nëse Plaku Novak nuk të del përpara me fytyrën e tij të zymtë dhe kallpakun mbi kokë, unë jam fajtor.....! (Veselinović, 1895, 4)

Branisllav Nushiq në përshkrimin e Liqenit të Ohrit, me të cilin e hap udhëpërshkrimin e vet, ka zhvilluar një alegori më të gjetur, në të cilën liqeni i trazuar bëhet metaforë e kombit serb:

Por sa madhështor dhe i mnershëm duket ky liqen i butë në çastin e stuhisë! Si një div i mbërthyer, ai me përpjekje të çmendura godet muret e ftohta të burgut, i hedh prangat, reziston dhe me ulërimën e vet ua fut mnerën rojave të veta. Qielli mbi të shtanget dhe i zbret retë poshtë, ndërsa liqeni lëviz nga thellësia dhe i ngre valët e tij të hatashme që përshëndeten me ulërimën trimërore dhe merren grykë me përqaftimin burrëror. Vallë, mos qielli e ngre te vetja robin dhe e ledhaton me ngushëllim, ose robi thyhet dhe lufton t'i shkëpusë prangat dhe të shqitet qiellit, lirisë së përrjetshme?! (Нушић, 1984).

Udhëpërshkruesit nga Serbia e Vjetër dëshirojnë posaçërisht të tregojnë sheshit për pakuptimësinë e kufirit ndërshtetëror që i ndan Mbretërinë e Serbisë dhe Perandorinë Osmane dhe këtë e bëjnë, nga njëra anë, duke theksuar “pdukshmërinë” e vetë kufirit, e nga ana tjetër, duke i krahasuar gjuhën, zakonet dhe rrethanat nga Serbia e Vjetër dhe Mbretëria e Serbisë, si dhe duke pohuar homogjenitetin e tyre thelbësor, përkundër dallimeve të dukshme. Ndërkohë që kjo e fundit presupozonte reflektim shkencor, para së gjithash në fushën e filologjisë dhe etnologjisë, mënyra e parë zbatohet me përdorimin e figurave poetike dhe përshkrimeve, prandaj kryesisht mbështetet te frymëzimi dhe dhuntia letrare e rrëfimtari. Është mbresëlënëse përshkrimi shpirtëror dhe i gjallë i Novakoviçit tek po kalonte kufijtë me Turqinë:

“Cili është kufiri?” – i pyeta unë përcjellësit e mi. Dhe ata ma treguan një llogore të vogël, gati të mbuluar.

“Ky është, zotëri, kufiri!”

Ndërsa unë po vrojtoja me kujdes atë vijë që e ndan tokën nga toka, ndikimin nga ndikimi dhe një popull të njëjtë mes vetes. A duhet ta them, se kam dashur, që të mos shihet as aq sa sytë e mi të dobësuar e shihnin? (Новаковић, 1894, 6-7)

Gati dhjetë vjet më vonë, në gati po të njëjtin vend, Novakoviç do të vërë re se “shihet [...] që ky është një vend, i prerë me marrëveshje ndërkombëtare; dihet që nga të dyja anët e vijës kufitare është i njëjti popull” (Новаковић, 1906, 3).

Motivi i tretë, motivi i *kërcënimit*, i përshkon në mënyrë mbresëlënëse udhëpërshkrimet nga Serbia e Vjetër, qoftë kur është fjala për kërcënimin ndaj sigurisë personale të vet udhëpërshkruesit, qoftë kur bëhet fjalë për kërcënime përmasash më të gjera, për mbijetesën e një kombi të tërë. Ndërkaq, këto dy nivele vazhdimisht gërshetohen dhe lidhen në një ndjenjë të njësuar: udhëpërshkruesi nisët nga përshkrimi i një kërcënimi të drejtpërdrejtë për vetë atë, që më pas të nxjerrë në pah se nën kërcënim është si popullata e viseve që i përshkruan, ashtu edhe trashëgimia kulturore nacionale. Kërcënimi dhe ndjenja e pasigurisë nuk përfaqësojnë vetëm një motiv letrar a reportazhi, por një teknikë me të cilën vetë akti i “leximit” të udhëpërshkrimit shndërrohet në një praktikë me emocionalitet të lartë. Është posaçërisht me rëndësi se në çfarë mënyre shuhet kufiri midis sigurisë personale dhe sigurisë së kombit si tërësi, ku ndjenja e rrezikimit në planin e kombit përkthehet nëpërmjet rrezikimit të sigurisë të vetë udhëpërshkruesit, çka përcillet si ndjenjë e pasigurisë dhe kërcënimit në trupin e vet lexuesit – konsumuesit të fundit. Jo rrallë udhëpërshkrime të tëra janë të mbushura me ndjenjën e rrezikut të vazhdueshëm të udhëtarëve, i cili gërshetohet me rrezikun nga vdekja biologjike ose kulturore e kombit. Kështu, Gopçeviç në rrëfen se në udhëtimin e tij kishte marrë me vete helm – “një shishëz të vocërr cianuri” – në rast se binte “në robëri të hajdutët maqedonë”, të cilët shpesh “me tortura dinake shantazhojnë dhe kërkojnë paratë për t’u liruar” (Гопчевић, 1890, 22). Udhëpërshkrimi i Millojeviçit është i gërshetuar në mënyrën më eksplicite me një varg skenash, të cilat përshkruajnë si është e rrezikuar siguria e tij personale, e madje tregohet edhe një ndodhi, në të cilën cubat shqiptarë qëlluan me pushkë mbi përcjellësit e tij para hyrjes në han (Милојевић, 1871, 127-128). Mirëpo, nga niveli personal, kërcënimi ngrihet në nivelin e mbarë kombit: në Serbinë e Vjetër, në përleshje me popullatën shqiptare, për serbët është në rrezik mbijetesë biologjike.<sup>13</sup> Përshkrimet e rrezikimit fizik dhe dhunës mbi serbët shfaqen që te Jurishiç (krah. Јуришић, 1852, 122-123) dhe mund të ndiqen praktikisht në të gjitha udhëpërshkrimet nga Kosova. Flitet se si serbët, nën trysinë dhe dhunën e vazhdueshme të pushtetit osman, braktisin besimin dhe kombin e vet, duke interpretuar kështu popullsinë shumicë të shqiptarëve (arnautëve) dhe “turkoshakëve” si pinjoj të serbëve nga mesjeta, ndërsa në Maqedoni kultura serbe humbet para “propagandës agresive bullgare”. Millosh Millojeviç në përshkrimet demografike të pjesëve të caktuara të Kosovës (siç është rrethina e Pejës, Prishtinës dhe

<sup>13</sup> Gërshetimi i motivit të kërcënimit në nivele të ndryshme është i pranishëm edhe në tekstin e Todor Stankoviçit (Станковић, 1910); kështu autori, ashtu si Millojeviç, përfshin episodin në të cilin është qëlluar mbi të (30-31), e nëpër tekst e gërsheton ligjërimin mbi shkatërrimin e kishave dhe përmendoreve serbe (22, 24), mbi shkapërderdhjen demografike të kombit për shkak të përndjekjes, kolonizimit, pagëzimit ose braktisjes së gjuhës serbe (20), si dhe, më në fund, me ankesën e vazhduar për dhunën e përditshme mbi serbët (24), duke arritur një efekt sinergjie në narracionin e shkapërderdhur.

Mitrovicës) madje nuk pranon se ka mysliman të tjerë përveç “serbëve të islamizuar – turkoshakëve”. Kombi nuk është i rrezikuar vetëm në nivelin e pasqyrës demografike dhe gjendjes numerike, por janë në rrezik edhe veçoritë fisnike racore serbe. Millojeviqi kështu rimerr diskursin e “papastërtisë” nga udhëpërshkrimet e Orientit dhe Ballkanit dhe e zbaton te “tjetri racor” në raport me kombin serb, duke mos i kursyer fjalët për të nxitur neverinë dhe gërditjen te lexuesit e vet të ardhshëm:

Në katin e sipërm qenë mbledhur të gjithë rreth vatrës, si korba dhe shkaba rreth një kërmë. Aty mund të shihej tipi i pastër serb dhe turkoshakët serbë, ndërsa tani të ashtuquajturit arnautë; tip përzierje e serbes dhe osmanes, shqiptares dhe osmanes, shqiptares dhe serbes, osmanes dhe ciganes etj. Me një fjalë, aty kishte përfaqësues të të gjitha kombësive, të cilët si ujqër të uritur u turrën në këtë tokë serbe të vërtetë e të pastër. Faqezi, i bardhë, i zi e i kuq, të panumërt, papastërti, plehra, neveri, përbërja e të gjitha qelbësirave në një, shikime të egra, si te të shastisurit dhe të tërbuarit, na lanë mbresa të tmerrshme, te të cilët kishte më shumë gërdi dhe fëlliqësi, pikërisht të vjella, nëse guxojmë të shprehemi ashtu siç qe, po çfarë frike, tmerrri kishte, në vend të të mirës e të bukurës. Përfytyrojeni një grumbull të tillë njerëzish përsosmërisht të zinj dhe të yndyrshëm, që nuk vishen mbase një herë brenda vitit, që ndoshta kurrë nuk krihen dhe nuk lahen dhe e cila qe stisur në karakollin e vogël, të papastër, mbase që kur është ndërtuar; pastaj do të mund të përfytyroni gërdinë dhe neverinë, posaçërisht për atë që, për herë të parë në jetën e vet, shikon pamje të tilla. (Милојевић, 1871, 103-104)

\* \* \*

Duke udhëtuar nëpër tokat e Perandorisë Osmane, udhëpërshkruesit serbë jo rrallë kanë qenë të detyruar të pranojnë se atje kishin takuar banorë të atyre viseve për të cilët nuk ishin të sigurt cilit komb i përkasin. Për ambivalencën e bashkëbiseduesve të tyre në Serbinë e Vjetër dhe në Maqedoni flet në mënyrë eksplicite Gopçeviçi, i cili citon bisedat me vendasit që kanë pranuar se për nga zakoni për veten thonë se janë bullgarë, edhe pse në të vërtetë janë serbë (Гопчевић, 1890, 26-27). Kështu pyetjes së Gopçeviçit “ti je, pra, serb?”, bashkëbiseduesi i tij do t’i përgjigjet “E di, pas të gjitha gjasave jemi serbë, por e kemi shprehi të themi se jemi bullgarë [...] i këtyllë është zakoni ynë” (Гопчевић, 1890, 33).<sup>14</sup> Jovan Cvijiç ka nxjerrë konkluzionin se “te sllavët maqedonas nuk ka [...] një vetëdije endogjene popullore”, prandaj ata “njësoj, shpejt dhe lehtë identifikohen edhe me serbët, edhe me bullgarët” (Цвијић, 1906, 13). Deklarimi personal mbi përkatësinë nacionale, është më se e qartë, nuk ishte kriter mjaft i besueshëm për ta përcaktuar përmasën e kombit serb dhe për t’iu përgjigjur pyetjes, në shikim të parë, së thjeshtë që e kishte shtruar Vuk Karaxhiçi në tekstin

<sup>14</sup> Për një situatë të ngjashme rrefën edhe Spiro Kalik, i cili rrugës nëpër Maqedoni pyeti një djalë nëse ishte serb, po me të marrë përgjigjen se është bullgar, i shtroi pyetjen shtesë se si qe kjo e mundur kur fliste serbisht, të cilës djali iu përgjigj: “Ashtu më ka thënë mësuesi, se jam bullgar, ndërsa babai më thotë se jam serb, si ai” (Калик, 1894, 21).

e tij *Serbët të gjithë e kudo ku janë*: “deri ku ka serbë?” (Караџић, 1972, 31). Në këtë periudhë historike kombi është parë më shumë si një e dhënë objektive dhe natyrore, e më pak si çështje e zgjedhjes personale të individit, prandaj për hulumtuesit ishte e domosdoshme të vendosin kritere objektive dhe shkencore për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Jovan Cvijiќi mbronte qëndrimin se “problemi politik maqedonas” zgjidhet “në pajtim me konstatimet shkencore”, duke shtuar se “nuk ka dyshim që edhe në një masë popullore fluide, e cila nuk e ka një ndjenjë popullore të përcaktuar as serbe, as bullgare, mund të gjenden në gjuhë dhe tradita historike tipare, shenja dhe gjurmë serbe e bullgare” (Цвијић, 1906, 17). Në realizimin e projektit të vërtetimit shkencor të përkatësisë nacionale të një popullate të papërcaktuar, dy disiplina ishin posaçërisht të dobishme: filologjia dhe etnografia.

Kriteri herderian i gjuhës nacionale gjatë shekullit XIX ishte gjerësisht i pranuar për dallimin e kombeve në Evropë (Anderson, 1991, 67-82; Geary, 2007, 46-51), ndërsa që nga Vuk Karaxhiќi gjuha është vendosur si kriter themelor i përkatësisë edhe në rastin e kombit serb. Edhe pse ky kriter ishte vënë në pikëpyetje në hapësirën e Austro-Hungarisë, ku folësit e dialektit shtokav, të cilët ishin të besimit katolik e mysliman, nuk dëshironin që të deklarohen si serbë,<sup>15</sup> ai ishte plotësisht i vlefshëm në hapësirën e Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë. Këtu, nga njëra anë, u deshte të dëshmohet se myslimanët (turqit, “turkoshakët”, por edhe shqiptarët – “arnautët”) janë në të vërtetë serbë të konvertuar, e nga ana tjetër, të tërhiqet kufiri kundruall projektit nacional bullgar që ishte konkurrent, ku nuk ekzistonte diferencimi sipas religjionit. Shumë autorë, si Stojan Novakoviќ dhe Spiridon Gopçeviќ, janë përpjekur që t’i përcaktojnë kriteret e qarta shkencore-filologjike, sipas të cilave gjuha që flisnin sllavët maqedonas të përfshihej në dialektet e gjuhës serbe, e jo të asaj bullgare. Për Stojan Novakoviќin një nga kriteret bazë të diferencimit është ai fonetik, prandaj ky autor thekson se prania e shkronjave e tingujve “đ” (“g”) dhe “č” (“q”), është një shenjë e sigurt se “gjuha maqedone” është në të vërtetë një e folme e gjuhës serbe (Новаковић, 1889). Dalluesit e diferencimit të Gopçeviќi përfshijnë si çështjet e fonetikës, ashtu edhe çështjet e leksikut, gramatikës, akcentimit, përdorimit të përemrave, si dhe prapashtesave dhe parashtesave. Tek ai theksohet veçanërisht se gjuha e sllavëve maqedonas është edhe më e afërt me gjuhën “serbe” mesjetare, respektivisht me gjuhën që hulumtuesit e hasnin në monumentet e shtetit mesjetar serb, se me gjuhën bashkëkohore letrare serbe (Гопчевић, 1890, 250-257).

Mirëpo, siç e ka vënë re edhe vetë Cvijiќi, një mënyrë e këtitill e përdorimit të filologjisë kishte mangësi. Nga njëra anë, vetë hulumtuesit janë shpesh të pabesueshëm dhe i (për)njohin gjërat që i kanë të afërta, ndërkohë që, nga ana tjetër, folësit e ndryshojnë me lehtësi dhe e përshtasin gjuhën e vet në pajtim me nevojat dhe situatat.<sup>16</sup> Dukej se etnografia premtonte një metodë më të sigurt, sepse bazohej në

<sup>15</sup> Karaxhiќi vetë kishte deklaruar në vitin 1861 se “nëse patriotët kroatë nuk mund të pajtohen me këtë ndarje (gjuhësore) të bazuar në arsye, atëherë tash për tash nuk mund të bëhet asgjë tjetër por të dallohemi nga besimi ose feja” (Зундхаусен, 2009, 103-104).

<sup>16</sup> Cvijiќi konkludon: “Nuk është e qartë as sot nëse të folmet maqedonase janë një gjuhë e veçantë sllave me më shumë dialekte, megjithëse një gjë e tillë është gati e pabesueshme, ose janë dialekte dhe nëse janë, në tërësi, më afër gjuhës bullgare ose serbe” (Цвијић, 1906, 18).

hulumtimin e zakoneve dhe traditës gojore, të cilat, siç besohet, arrinin deri në kohën mitike, para-historike. Në të vërtetë, ngritja e nacionalizmit modern bazohej dhe ishte e lidhur pashkëputshëm me disiplinën e etnografisë, respektivisht etnologjisë. Nacionalizmi bazohej mbi idetë e “autenticitetit”, prandaj hulumtimi i folklorit, në trajtën e zbulimit dhe konservimit të shtresave kulturore të harruara, arkaike dhe të rrezikuara, që nga fillet e tij përfaqësonte një instrument të fuqishëm në duart e ideologjisë nacionaliste. Interesimi për hulumtimin e “kulturës popullore” zhvillohej bashkë me idetë e nacionalizmit, prandaj studimet e folklorit, nëpërmjet diskurseve mbi “autenticitetin”, përfaqësonin një burim argumentesh shkencore mbi të drejtat natyrore dhe historike të kombit (krah. Bendix, 1997). Të kuptuarit e etnologjisë si të pandashme nga idetë e kolektivitetit dhe popullit, respektivisht kombit, ishte i shprehur edhe në veprat e shkencëtarëve serbë në kapërcyellin e shekujve XIX dhe XX. Tihomir Gjorgjeviq në veprën e tij *Mbi etnologjinë* të vitit 1906 shtron pikëpamjen se “etnologjia i vë në pah jo mendimet e individit, por të popullit, grupeve”, prandaj “etnologut nuk i intereson ajo që një individ do të konsideronte si të mirë, të vërtetë dhe të bukur, ose atë që shkon pas mendimit dhe vullnetit të tij, por atë që i përgjigjet mendimit të përgjithshëm të popullit” (Ђорђевић, 1906, 5). Krijimi i lidhjes kauzale midis zakoneve dhe kombit ishte po ashtu i rëndësishëm, sepse në atë mënyrë çështja e kombit nuk ishte më çështje e përkatësisë vullnetare dhe bëhej çështje e sjellë gjer në nivelin e praktikave të përditshme zakonore, të cilat me anë të etnologjisë si shkencë mund të hulumtohen dhe përshkruhen në mënyrë të besueshme.

Pikërisht për këtë arsye etnologët dhe udhëpërshkruesit që kanë hulumtuar Serbinë e Vjetër dhe Maqedoninë janë përpjekur të dëshmojnë se popullata sllave e këtyre viseve të Perandorisë Osmane ka të njëjtat zakone dhe folklorin e ngjashëm si serbët në “viset veriore”, respektivisht në Mbretërinë e Serbisë dhe në Austro-Hungari. Si treguesi më i rëndësishëm i traditës serbe është theksuar shënimi i festës së shtëpisë të shenjtorit mbrojtës. Këtu pajtohen autorët si Tihomir Gjorgjeviq, Spiridon Gopçeviq dhe Millojko Veselinoviq, duke i përshkruar zakonet e festave dhe duke i krahasuar me zakonet e afërta në vetë Serbinë (Ђорђевић, 1920, 155; Гопчевић, 1890, 259-263). Autorët si Millosh Millojeviq dhe Millojko Veselinoviq janë marrë me zakonet e Serbisë së Vjetër, duke i paraqitur në kuadër të shqyrtimeve më të gjera të zakoneve serbe. Kështu Millojeviq në librin e parë të studimit të tij *Këngët dhe zakonet e tërë popullit serb* transmeton këngët e shënuara në Serbinë e Vjetër, me komente rreth përdorimit të tyre në kuadër të riteve karakteristike për zakonet serbe (Милојевић, 1869). Në këtë diskurs një vend të veçantë e zë studimi voluminoz i konsullit rus në Prizren, Ivan Stepanoviç Jastrebov (Иван Степанович Ястребов), për zakonet dhe këngët e serbëve nga rrethina e Prizrenit, Pejës, Dibrës dhe lumit Ibër (Ястребов, 1886).<sup>17</sup> Jastrebov përshkruan në detaje zakonet që, sipas rregullit, lidhen me festa kishtare dhe shënon këngët që këndohen në ato raste, duke u sjellë në një rreth të ngjashëm

<sup>17</sup> Studimi i Jastrebovit nuk ishte përkthyer në gjuhën serbe, por meqënëse ai u shkrua në gjuhën ruse, drejtshkrimi i së cilës në atë kohë ishte më afër sllavoserbishtes dhe duke marrë parasysh faktin se autori ishte shfaqur në shtypin serb, për shembull në gazetën *Srpstvo* me një shkrim të përkthyer, mund të konkludohet se ky studim që në dispozicion dhe ishte i kuptueshëm për publikun lexues në Beograd.

temash si Gopçeviqi dhe Millojeviqi, duke veçuar posaçërisht festën e shtëpisë, si dhe shënimin e Ditës së Shën Gjergjit të përcjellë me të ashtuquajturat këngë bimësh. Duke e paraqitur tekstin e tij si “shënime udhëtimi”, Jastrebovi në të vërtetë ofron një hibrid specifik të prozës udhëpërshkruese, studimit etnografik dhe përmbledhjes së këngëve “të mbledhura” popullore.

Gopçeviqi dhe Millojeviqi, duke veçuar posaçërisht festën e shtëpisë, si dhe shënimin e Ditës së Shën Gjergjit të përcjellë me të ashtuquajturat këngë bimësh. Duke e paraqitur tekstin e tij si “shënime udhëtimi”, Jastrebovi në të vërtetë ofron një hibrid specifik të prozës udhëpërshkruese, studimit etnografik dhe përmbledhjes së këngëve “të mbledhura” popullore.

Strategji të ngjashme përvetësimi janë përdorur edhe në studimin e folklorit, pra – në kuptimin e të ngushtë të fjalës – të traditave gojore popullore, këngëve popullore, kulturës materiale, duke u përpjekur që në mënyrë “objektive” dhe shkencore ato të mund të përcaktoheshin si serbe. Këngët popullore të mbledhura fillimisht i nënshtroheshin analizës gjuhësore, e cila duhet të dëshmonte se vërtetë ishin kënduar në serbisht, e jo në gjuhën konkurrenente bullgare. Tematika, respektivisht analiza e motiveve që shfaqen në këto këngë, ishte njësoj e rëndësishme, nëse jo edhe më e rëndësishme për përcaktimin e përkatësisë nacionale. Nënkuptohej se çdo komb zotëron një ndjesi të vetën poetike, sipas të cilit krijimet e traditës së tij gojore mund të dallohen qartas nga krijimet e kombeve tjera, prandaj shtrohej pyetja në çka konsiston kjo ndjesi unike dhe si të dallohet ajo (Leerssen, 2012, 11-26). Si dëshmi se kënga i përket kombit serb shihej përmendja në to e personaliteteve nga historia mesjetare serbe, ndërsa si protagonistin më të rëndësishëm në këngët nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia komentuesit veçonin Princ Markon (Гопчевић, 1890, 264; Jovanović, 2010, 34-36). Jastrebovi jo rrallë ofron variantet e këngëve nga përmbledhjet tanime kanonike të Karaxhiqit, ndërsa me analizën krahasimtare të motiveve shtron tezën se Kosova është Serbia e Vjetër edhe në sensin poetik, si territor në të cilin është krijuar bërthama poetike e poezisë popullore serbe, prej nga ajo ka migruar në veri dhe në veriperëndim (Jovanović, 2010, 38). Më në fund, ilustrime të shumta të veshjeve popullore, që shfaqeshin jo vetëm në studimet shkencore, por edhe në revista të ilustruara, siç është *Nova iskra*, kishin për qëllim që t’i afronin publikut lexues në veri kulturën materiale të popullsisë së Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë, si dhe që edhe në këtë nivel ta parashtronë qartë hapësirën e përbashkët dhe unike nacionale e kulturore.<sup>18</sup>

Hulumtuesit-etnografët kanë theksuar se ligjërimi i tyre për gjuhën, folklorin dhe zakonet është i pashkëputshëm nga territori që ky material duhej të përfaqësonte, prandaj projektet e tyre etnografike përbëjnë *par excellence* shembuj të vendosjes së kombit në hartën gjeografike. Qoftë kur arti popullor dhe zakonet trajtohen në kuadër të prozës udhëpërshkruese, qoftë edhe kur është fjala për studime etnografike, ato

<sup>18</sup> Rreth përdorimit të veshjeve/kostumeve popullore në prodhimin e kombit krah. Макуљевић, 2006, 135-137.

janë gjithmonë të përcaktuara gjeografikisht qartë, ndërsa për dimensionin kohor të krijimit të tyre flitet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Si rregull, etnografët dhe udhëpërshkruesit e trajtonin popullatën e një visi si jashtëzakonisht stabile, e duke konkluduar për përcaktimin e saj nacional, njëkohësisht përvijësonin edhe hartën e “atdheut” kombëtar. Siç thekson Holm Zundhausen (Holm Sundhaussen), etnologjia në Serbi që nga themelimi i saj “ka patur një rol kyç në formësimin mental të kombit dhe legjitimimin e aspiratave territoriale” (Зундхаусен, 2009, 209). Se deri në çfarë mase të menduarit hapësinor i kombit është brendashkruar në vetë metodën e etnologjisë dëshmon studimi i Tihomir Gjorgjeviqit rreth përcaktimit të kësaj disipline, në të cilin autori shtron mendimin se, duke patur parasysh faktin që folklori është i pandashëm nga kombi, etnologu, i cili ka për detyrë të hulumtojë një popull, duhet të kufizohet në “fushën e atij populli”, pastaj të mbledhë lëndën dhe të interpretojë “atë që për atë popull dhe dukuritë e format e tij është karakteristike”, “duke u marrë me [folklorin] në një territor të kufizuar të një populli ose një krahine të kufizuar” (Ђорђевић, 1906, 12). Në një vend tjetër Gjorgjeviq ishte edhe më eksplicit:

Folklori ynë ka për ne edhe *rëndësi politike*, sepse ai është një mjet i fuqishëm për përcaktimin e kufijve nacionalë. Me të nocioni popullor ia ka tërhequr vetvetes kufirin nacional. I njëjti objekt i shprehur me gjuhën e njëjtë dhe mënyrën e njëjtë nga Deti Adriatik deri në Ballkan dhe nga Deti i Bardhë deri në Budim, nuk e dimë çka do të mund të shenjonte tjetër përveç faktit se është produkt i shpirtit dhe e arritur e *një populli*. (Ђорђевић, 1984, 19).

Ky përdorim i etnografisë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX ishte i rëndomtë edhe në suaza më të gjera evropiane, ndërsa roli i saj politik ishte posaçërisht i shprehur në viset kufitare, ku përkatësia nacionale e popullatës nuk ishte e përcaktuar gjer në fund. Një shembull paradigmatic është studimi i Leon Dominianit i vitit 1917 mbi rolin e gjuhës dhe të zakoneve në vendosjen e kufijve në Evropë, i cili kishte edhe ndikim të drejtpërdrejtë politik në rrjedhën e negociatave të Versajës (Dominian, 1917; krahu. Leerssen, 2012, 18-19). Pikërisht në kontekstin e rolit të etnologjisë si disiplinë e vendosjes në hartë të kombit është e nevojshme të vrojtohet edhe kthesa e theksuar e etnologëve drejt rurales, si dhe vlerësimi i lartë i kulturës së fshatit dhe folklorit, të cilat u bënë një tipar i theksuar i tërë diskursit nationalist. Popullatat urbane jo vetëm që ishin jostabile dhe të prira drejt migrimit, por në hapësirën e Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë binin ndesh qartazi me aspiratat e elitës intelektuale serbe, duke patur parasysh se në to dominonte kultura osmane. Përkundër kësaj, konsiderohej se popullata rurale kulturalisht ishte vendase dhe se mund të shërbente si burim “autentik” i materialit etnografik, si një repozitorium i traditës orale atemporale dhe si një objekt i përshtatshëm për projektin e vendosjes në hartë.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Rreth problemit të rurales te Gjorgjeviq krahu. Čolović, 2000, 143-155.

Mekanizëm kulminant i etnologjisë si shkencë për vendosjen e kombit në hartë gjithsesi ishin “hartat etnografike”, të cilat si rregull jepeshin si shtojcë në studimet etnografike, por edhe në prozën udhëpërshkruese. Hartat etnografike të Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë ishin, nga njëra anë, medium i paraqitjes së rezultateve shkencore tepër joshëse, ndërsa nga ana tjetër, të konstruara dhe shpesh tepër arbitrare. Edhe më shumë se në rastin e udhëpërshkrimeve, këto harta u prodhuan në arenën ndërkombëtare në konflikt të hapur me (etno)hartografët që mbështesnin projektet nacionaliste rivale dhe të cilët kishin pikëpamje të tjera të zgjidhjeve të mundshme të Çështjes Lindore, respektivisht të Çështjes Maqedone. Këto harta nuk dalloheshin midis tyre vetëm për nga përcaktimi i kufijve, por edhe për faktin se cilat kategori etnike duhej t’i nënshtroheshin “demarkacionit”. Në hartën etnografike të Millosh Millojeviqit mund të hasen serbo-maqedonët, serbo-bullgarët, serbo-rashianët, pastaj hapësira nacionale serbe praktikisht e mbulon pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik të përfshirë në hartë, ndërsa në atë të Goçeviçit janë shenjuar “grekët me prejardhje serbe”, “shqiptarët me prejardhje serbe”, si dhe “serbët muhamedanë”. Është interesant fakti se Cvijiqi në fillim të shekullit XX e ka analizuar në mënyrë tepër kritike këtë praktikë të bërjes së hartave etnografike, duke konkluduar se “në të gjitha hartat etnografike bullgare, sllavët maqedonë janë shenjuar si bullgarë, në ato serbe si serbë, ndërsa në ato greke janë shënuar me ngjyrën greke jo vetëm grekët, por edhe shumica ose të gjithë sllavët maqedonas” (Цвијић, 1906, 53). Mirëpo, Cvijiqi edhe vetë ka prodhuar një varg hartash etnografike midis viteve 1906 dhe 1918 dhe në to “sllavët maqedonë” herë i ka hequr e herë i ka kthyer në hartën e Ballkanit, e ka lëvizur kufirin midis serbëve dhe bullgarëve, si dhe ndryshe e ka ngjyrosur hartën me qëllim që territorin e Maqedonisë ta paraqiste si të afërt me Serbinë. Fakti që etnologjia nuk ka mundur të shkëputet nga nevoja që të shprehet me harta (të cilat për nga natyra e tyre e anulonin mundësinë e paraqitjes së heterogjenitetit të kulturave të një hapësire gjeografike) edhe një herë flet për parimin e saj bazik nacional e territorial të hulumtimit, si dhe për konotacione thelbësore nacionale-politike prej të cilave kurrë nuk është e ndarë.

Përshkrimi i gjuhës dhe i folklorit ishte pjesë e pandashme e udhëpërshkrimeve nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia dhe njëkohësisht një nga mekanizmat e rëndësishëm, me të cilin udhëpërshkruesit i paraqisnin këto vise si pjesë të atdheut serb. Pikërisht duke i përshkruar, mbledhur dhe hulumtuar gjuhën dhe folklorin, udhëpërshkruesit kanë mundur që gjoja nga një perspektivë objektive të dëshmojnë se këto vise i përkasin atdheut serb, por edhe që përvojën e vet t’ia afrojnë publikut lexues në Mbretërinë e Serbisë dhe në Austro-Hungari. Në fund të fundit, përfundimet e tyre, rregullisht, flisnin në favor të qëndrimit se midis gjuhës dhe zakoneve të serbëve në Mbretëri dhe në Monarkinë Austro-Hungareze, nga njëra anë dhe popullsisë së Serbisë së Vjetër, në anën tjetër, nuk ka dallime kyçe dhe kufij që do të sillnin te moskuptimi kulturor i pjesëtarëve të këtyre dy popullatave. Përkundrazi, përvojat e tyre kanë folur për faktin se, gjykuar në pajtim me ato kritere, fjala është për të njëjtin popull, të cilin jo vetëm që e lidhin prejardhja etnike dhe karakteristikat racore, por edhe kultura, folklori dhe gjuha unike.



Mirëpo, është e rëndësishme po ashtu të hetohen edhe dallimet në mekanizmat e përvetësimit shkencor të territoreve midis hapësirës që është shenjuar si Maqedoni, ku kombi rival ishte Bullgaria, si dhe të Serbisë së Vjetër në kuptimin e ngushtë të fjalës, respektivisht Kosovës dhe Shqipërisë veriore, e cila ishte e banuar me shumicë nga popullsia shqiptare. Përderisa në rastin e parë udhëpërshkruesit dhe shkencëtarët në masë të plotë i shqyrtonin të dhënat aktuale demografike, si dhe praktikën gjuhësore dhe zakonore, duke u përpjekur të dëshmojnë se popullsia maqedonase është më e afërt me kombin serb sesa me atë bullgar; në rastin e dytë udhëpërshkruesit e injoronin shpesh realitetin duke përdorur ekskurset në fushën e historisë, gjeografisë, ose madje me interpretime të dyshimta të pasqyrës demografike. Duke lëvizur nëpër Serbinë e Vjetër, udhëpërshkruesit, kanë krijuar iluzionin narrativ se po lëvizin në një kohë historike të llojit të veçantë, ndërsa reflektimet e tyre ishin më tepër të orientuara te historia mesjetare dhe tiparet gjeografike të viseve, se sa te jeta aktuale e komunitetit. Më në fund, kur është dashur të shqyrtohen të dhënat demografike, udhëpërshkruesit jo rrallë pohonin se popullsia që nuk identifikohet me kombin serb, gjuhën ose, respektivisht, besimin ortodoks, apo ishte konvertuar së voni dhe kishte kaluar në një gjuhë tjetër, ose ishte vendosur në ato territore në kohë të vona, ose ishte konvertuar. Në këtë mënyrë, jo vetëm që territoret e Serbisë së Vjetër pamëdyshje shenjoheshin si serbe, por apriori i paraprihej mohimit të të drejtave politike dhe i të drejtës së deklarimit të gjithë popullatës joserbe, e cila shpesh shihej si e “papastër”, e rrezikshme, si tjetri racor dhe kulturor.

Në bazë të analizës së paraqitur mund të konkludohet se për krijimin e mitit mbi Serbinë e Vjetër nevojiteshin të dhëna që jo rrallë janë fabrikuar ose interpretuar me tendenciozitet, por edhe konteksti diskursiv në të cilin po këto të dhëna paraqiteshin si përvojë e drejtpërdrejtë e narratorit dhe e vërtetë e pamëdyshje. Më në fund, mënyrat se si janë paraqitur të dhënat për Serbinë e Vjetër ishin të menduara me qëllimin që të nxisin te lexuesi reagime emocionale dhe të nxisin identifikimin e individit me kombin si komunitet i përfytyruar. Si i tillë, diskursi i udhëpërshkrimeve nga Serbia e Vjetër është transformuar në një mekanizëm të përvetësimit të territoreve në favor të projektit të nacionalizmit serb, si dhe mohimit të të drejtave politike banorëve aktualë të krahinës së shenjuar si Serbia e Vjetër, e para së gjithash popullsisë shqiptare. Pasojat politike të këtij projekti janë afatgjate, duke patur parasysh se shumë pikëpamje të intelektualëve serbë në kalimin nga shekulli XIX në shekullin e XX janë edhe sot të pranishme në diskursin e nacionalizmit serb, por edhe se tekste të përmendura jo rrallë edhe më tej përdoren në mënyrë aktive për justifikimin e tezave të shumta nacionaliste. Për këtë dëshmojnë botimet e përsëritura dhe rishtypjet e udhëpërshkrimeve të caktuara pa kurrfarë shqyrtimi të mirëfilltë kritik të kontekstit të krijimit të këtyre veprave, si edhe përdorimi jokritik i të dhënave pseudoshkencore në punimet bashkëkohore shkencore (si p.sh. krijimi i “hartave etnike” anakronike, krahu. Веміћ, 2005). Ballafaqimi kritik dhe kontekstualizimi i këtyre teksteve na zbulon se deri në ç’masë të “vërtetat” mbi të cilat bazohet një diskurs i caktuar i nacionalizmit, edhe vetë janë të fabrikuar në fazat më të hershme të zhvillimit të matricës së tij ideologjike.

## Literatura:

ANDERSON, B. (1991) *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*. Revised edition. London i New York: Verso.

BENDIX, R. (1997) *In Search of Authenticity. The Formation of Folklore Studies*. Madison i London: University of Wisconsin Press.

ČOLOVIĆ, I. (2000) *Politika simbola. Ogledi o političkoj antropologiji*. Bot. II. Beograd: Biblioteka XX vek.

DOMINIAN, L. (1917) *The Frontiers of Language and Nationality in Europe*. New York: American Geographical Society.

GEARY, P. J. (2007) *Mit o nacijama: srednjovekovno poreklo Evrope*. Përkth. D. Parenta. Novi Sad: Cenzura.

HEIM, M. (1966) *Spiridion Gopčević. Leben und Werk*. Wiesbaden: Harrassowitz.

JOVANOVIĆ, B. B. (2010) I. S. Jastrebov – skupljač naših najstarijih narodnih pesama na Kosmetu. *Književni pregled* 3. fq. 23–39.

LEERSEN, J. (2012) Oral Epic: The Nation Finds a Voice. në Baycroft T., Hopki D. (red.). *Folklore and Nationalism in Europe during the Long Nineteenth Century*. Leiden: Brill. fq. 11–26.

PROMITZER, C. (2015) Austria and the Balkans: Exploring the Role of Travelogues in the Construction of an Area. në Promitzer C., Gruber S., Heppner H. (red.). *Southeast European Studies in a Globalizing World*. Münster: LIT Verlag. fq. 189–206.

TRIFUNOVIĆ, B. (2014) *Collective Memory and the Sites of Memory in the Serbian Discourse on Old Serbia*. Doctoral thesis, Faculty of “Artes Liberales”, University of Warsaw. Mund të gjendet në <https://depotuw.ceon.pl/handle/item/1021> (u pa më 15. VI 2015).

БАТАКОВИЋ, Д. Т. (1988) *Савременици о Косову и Метохији. 1852–1912*. Београд: Српска књижевна задруга.

ВЕМИЋ, М. (2005) *Етничка карта дела Старе Србије. Према путопису Милоша Милојевића 1871–1877. год*. Београд: САНУ, Географски институт Јован Цвијић.

ГОПЧЕВИЋ, С. (1890) *Стара Србија и Македонија*. Përkth. Милан Касумовић. Београд: Парна штампарија Дим. Димитријевића.

ЂОРЂЕВИЋ, Т. (1984) *Наш народни живот, IV*. Чоловић И. (red.). Београд: Просвета.

ЂОРЂЕВИЋ, Т. Р. (1906) *О етнологији*. Београд: Штампарија Светозара Николића.

ЂОРЂЕВИЋ, Т. Р. (1920) *Македонија*. Панчево: Издавачка књижара „Напредак“.

ЗУНДХАУСЕН, Х. (2009) *Историја Србије од 19. до 21. века*. Përkth. Т. Бекић. Београд: Слио.

ЈОВАНОВИЋ, Ј. М. (1938) Нушић као конзул. *Српски књижевни гласник* 53. fq. 259–269.


КАЛИК, С. (1894) *Из Београда у Солун и Скопље с Београдским певачким друштвом. Путничке белешке*. Београд: Штампарија П. К. Танасковића.

КАРАЦИЋ, В. С. (1972) *Етнографски списи*. Филиповић. М. С. (red.). Београд: Просвета.

МАКУЉЕВИЋ, Н. (2006) *Уметност и национална идеја у XIX веку. Систем европске и српске визуелне културе у служби нације*. Београд: Завод за уџбенике и наставна средства.

- МИЛОЈЕВИЋ, М. С. (1869) *Песме и обичаји укупног народа србског. Књ. 1. Обредне песме*. Београд: Државна штампарија.
- МИЛОЈЕВИЋ, М. С. (1871) *Путопис дела Праве – Старе – Србије*. Београд: Главна срп. књижара Јована Д. Лазаревића.
- МИЛОЈЕВИЋ, М. С. (1881) *Народописни и земљописни преглед средњег дела праве (Старе) Србије: са етнографском мапом српских земаља у кнежевинама: Србији, Црној Гори, Краљевини Румунији, Аустро-Угарској и Турској царевини*. Београд: Задруга штампарских радника.
- НОВАКОВИЋ, С. (1889) *Ђ и Ђ у македонским народним дијалектима*. Београд: Краљ. српска државна штампарија.
- НОВАКОВИЋ, С. (1894) *С Мораве на Вардар. По зидинама Цариграда. Бруса. Путне белешке*. Београд: Краљевска српска државна штампарија.
- НОВАКОВИЋ, С. (1906) Два дана у Скопљу. 14–15–16 јул 1905. Белешке и размишљања с пута. *Годишњица Николе Чупића* 25. fq. 1–58.
- НУШИЋ, Б. Ђ. (1894) *Крај обала Охридскога језера. Белешке из 1892 године*. Београд: Државна штампарија Краљевине Србије.
- НУШИЋ, Б. Ђ. (1902) *Косово. Опис земље и народа*, св. 1. Нови Сад: Матица српска.
- НУШИЋ, Б. Ђ. (1902) *С Косова на Сиње Море. Белешке с пута кроз Арбанасе 1894. године*. Београд: Дворска књижара Мите Стајића.
- НУШИЋ, Б. Ђ. (1903) *Косово. Опис земље и народа*. св. 2. Нови Сад: Матица српска.
- ПЕКОВИЋ, С. (ur.) (2001) *Књига о путопису*. Београд: Институт за књижевност и уметност.
- СРЕЋКОВИЋ, П. (1882) Путничке слике. Трећа слика. Подрим и Метохија. *Летопис Матице српске* 130, fq. 12–35.
- СТАНКОВИЋ, Т. П. (1910) *Путне белешке по Старој Србији 1871–1898*. Београд: Штампарија Ђ. Мунца и М. Карића.
- СТОЈАНОВИЋ, Д. (2007) Туризам и конструкција социјалног и националног идентитета у Србији крајем 19. и почетком 20. века. *Годишњак за друштвену историју* 13. fq. 41–59.
- ЦВИЈИЋ, Ј. (1904) Географски положај и опште географске особине Македоније и Старе Србије. *Српски књижевни гласник* 11. fq. 115–153
- ЦВИЈИЋ, Ј. (1906) *Проматрања о етнографији македонских Словена*. Београд: Г. Кон.
- ЈУРИШИЋ, Г. I. (1852) *Дечански првенацъ. Описаніе манастира Дечана, Диплома краља Дечанскогъ, Описаніе Ипекске Патріаршіе, многи стари зданія, многи мѣста старе Србіе и Косовскогъ поля*. Нови Сад: Нар. књигопечатња Дан. Медаковића.
- ЈАСТРЕБОВ, И. С. (1886) *Обычаи и пѣсни турецкихъ сербовъ. Въ Призрѣнѣ, Ипекѣ, Моравѣ и Дибрѣ. Изъ путевыхъ записокъ*. С.-Петербургъ: Типографія В. С. Балашева.

**Përktheu: Anton Berishaj**



**Srdjan Atanasovski**

Institute of Musicology

Serbian Academy of Sciences and Arts

## **Production of Old Serbia: Following the Travel-Writers, Tracing the Folklore**

### **Abstract:**

In this paper I analyse the travelogues from Old Serbia, which were a developed literary genre in Serbia at the end of the long nineteenth century, as a mechanism of vindicating the territorial claims of the discourse of Serbian nationalism. In the period when the portrayed lands were under Ottoman rule and deemed inaccessible to most of the Serbian population, which regarded them as the core of their national territory, these travelogues were unique way for the public to gain first-hand information about these lands. After a brief historical overview of the development of the genre, I analyse the literary mechanism through which these lands were efficiently labeled as Serbian. I particularly discuss the importance of scientific data copiously provided in the travelogues, on the issues of languages, customs, etc.

---

Keywords: Serbian nationalism, Old Serbia, Macedonia, travelogues, ethnography

